

**PROGRAME  
TË ARSIMIT  
PARASHKOLLOR**

**4-5 vjeçarët**

**Tiranë, 2007**

## **PROGRAMI I PARASHKOLLORIT PËR MOSHAT 4-5 VJEÇ**

### **A. FUSHAT KURRIKULARE**

- 1. Zhvillimi gjuhësor**
- 2. Zhvillimi matematikor**
- 3. Zhvillimi Shkencor**
- 4. Zhvillimi social dhe personal**
- 5. Edukimi artistik**
- 6. Edukimi fizik dhe shëndetësor**

# 1. PROGRAMI I ZHVILLIMIT GJUHËSOR

## I. LINJAT KURRIKULARE TË ZHVILLIMIT GJUHËSOR

### Linjat:

- Gjuhë për komunikim
- Gjuhë për të menduar
- Lidhja e tingujve me shkronjat
- Të lexuarit
- Të shkruarit
- Shkrim dore

## II. PROGRAMI I DETAJUAR I FORMIMIT GJUHËSOR SIPAS LINJAVE, OBJEKTIVAVE DHE KONCEPTEVE

Nr	Linjat	Objektivat	Konceptet
1	Komunikimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor dhe drejton pyetje të thjeshta. (<i>Shembull pyetjesh: Çfarë dite është sot? Çfarë do t'i veshim kukullës? Cilën formë do të përdorim?</i>)</li> <li>• Komunikon në mënyrë të kuptueshme me moshatarët</li> <li>• Pyet pse ndodhin disa gjëra duke shfaqur kureshtje dhe habi (<i>Shembull: Ku shkoi bora?..</i>)</li> <li>• Merr pjesë në biseda dhe dëgjon ngjarje apo histori.</li> <li>• Diskuton me dëshirë për çështje të ndryshme dhe të larmishme me moshatarët.</li> <li>• Formulon mendime duke përdorur fjali jo të sakta. (<i>Shembull: Unë dje kisha qenë tek gjyshi..</i>)</li> <li>• Flet rreth karakteristikave, ngjarjeve dhe ideve, por me mendime të shkëputura</li> <li>• Tregon respekt për të tjerët kur flasin</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Pyetje</li> <li>-Diskutim</li> <li>-Histori</li> <li>-Folës</li> <li>-Dëgjues</li> <li>-Rregulla të foluri</li> <li>- Respekt</li> </ul>
2	Të menduarit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor të folurit në bisedë</li> <li>• Përdor të folurit kur arrin të lidhë një ide të tijën</li> <li>• Përdor bisedën për të imagjinuar dhe përvojat e së ardhmes</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Të folurit</li> <li>-Të menduarit</li> <li>-Kujtesa</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmbledh përvojat personale, duke i lidhur me materialet që i lexohen</li> <li>• Kujton me saktësi ngjarje të jetuara dhe mban qëndrim ndaj ndodhive.</li> </ul>	<b>-Përvojë personale jetësore</b>
<b>3</b>	<b>Lidhja e tingujve me shkronjat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor qartë rimën në disa fjalë të thjeshta.</li> <li>• Thotë qartë të gjitha tingujt e alfabetit</li> <li>• Tregon disa shkronja që ai i njeh</li> <li>• Identifikon me gisht tek fjalët që kanë shkronjë të njëjtë (<i>Shembull: buka; byreku; brumi, etj</i>)</li> </ul>	<b>-Rimë</b> <b>-Tingull</b> <b>-Shkronjë</b> <b>-Fjalë</b>
<b>4</b>	<b>Të lexuarit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mban një material të shkruar në pozicionin e të lexuarit</li> <li>• Identifikon disa nga shkronjat e mëdha në mënyrë globale në një material të shkruar</li> <li>• Riprodhon me zë një tekst</li> <li>• Shpjegon vizatimet e tij</li> </ul>	<b>-Material i shkruar</b> <b>-Tingull</b> <b>-Të vizatuarit dhe të shkruarit</b>
<b>5</b>	<b>Të shkruarit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkruan emrin e tij me shkronja kapitale</li> <li>• Përdor ngjyrat, lapsin, në të shkruar</li> <li>• Identifikon materialet që përdoren për të shkruar</li> </ul>	<b>- Shkrimi i emrit</b> <b>-Mjetet e të shkruarit</b>

## 2. PROGRAMI I ZHVILLIMIT MATEMATIKOR

### I.Linjat e përmbajtjes

1. NUMRI
2. GJEOMETRIA DHE ORIENTIMI NË HAPËSIRË
3. MATJA
4. MODELE, MARRËDHËNIE DHE FUNKSIONE
5. MBLEDHJA E TË DHËNAVE

### II. Programi i detajuar sipas linjave dhe objektivave

LINJAT	NËNLINJAT	OBJEKTIVAT	KONCEPTET
1. NUMRI	<b>1.1 Numri</b> <b>1.2 Veprimet me numrat</b>	Fëmija të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të numëroje të paktën deri në 10.</li> <li>• Të lexojë numërorët të paktën deri në 10.</li> <li>• Të shkruajë numërorët të paktën deri në 6.</li> <li>• Të krahasojë dy numra deri në 6 bazuar në dy grupe sendesh.</li> <li>• Të mbledhë deri në 6 dy numra natyrorë duke bashkuar dy grupe sendesh.</li> <li>• Të zbresë dy numra natyrorë duke e konkretizuar me grupe sendesh me një ose dy njësi (p.sh. 5 mollë heqim 2 mollë, mbeten 3 mollë).</li> </ul>	- Kuptimi i numrit natyror deri në 10; - Koncepti i numrit rreshtor; - Vargu numerik; - Leximi dhe shkrimi i numrave deri në 10; - Krahasimi dhe rradhitja e numrave; - Mbledhja e numrave deri në 6; - Zbritja brenda numrit 6;

<p><b>2. GJEOMETRIA DHE ORIENTIMI NË HAPËSIRË</b></p>	<p><b>2.1 Figurat dhe trupat gjeometrikë</b></p>	<p>Fëmija të jetë i aftë:</p>	<p>- Figurat gjeometrike dydimensionale: katrori; trekëndori; rrethori; drejtkëndori;</p>
	<p><b>2.2 Marrëdhëniet hapësinore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të emërtojë figurat gjeometrike dydimensionale: katrori; trekëndori; rrethori;</li> <li>• Të gjejë forma ose pjesë të tyre, të ngjashme me figurat gjeometrike dydimensionale :katrori; trekëndori; rrethori;</li> <li>• Të përcaktojë vendndodhjen e një objekti, duke ju referuar një objekti tjetër ose vetes së tij dhe duke përdorur fjalë të jetës së përditshme (para - pas; poshtë – lart; afër – larg etj)</li> <li>• Të lëvizin në drejtime të caktuara, duke u orientuar nga fjalët (para; drejt; prapa derës; afër karriges; nën tavolinë; etj).</li> </ul>	<p>- Orientimi për vendndodhjen e objekteve në hapësirë, duke përdorur termat: para – pas; poshtë – lart; mbi – nën; etj.</p>

<p><b>3. MATJA</b></p>	<p><b>3.1 Gjatësia</b></p> <p><b>3.2 Masa</b></p> <p><b>3.3 Koha</b></p>	<p>Fëmija të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të masë gjatësi me njësi jostandarde (hapi; pëllëmba etj.)</li> <li>• Të klasifikojë sendet sipas gjatësisë;</li> <li>• Të renditë sendet dhe objektet sipas gjatësisë;</li> <li>• Të renditë fjalët që tregojnë kohën sipas rrjedhës së saj: mëngjes; drekë; mbasdite; mbrëmje; natë.</li> <li>• Të renditin ditët e javës dhe stinët.</li> <li>• Të renditë ngjarje të ndryshme të një dite (ardhja në kopsht; ngrënia e mëngjesit; lojë etj.)</li> <li>• Të shoqërojë veprimet me fjalët që tregojnë kohën e veprimit: në mëngjes; në drekë; mbasdite; në mbrëmje; natën; etj.</li> </ul>	<p>- Mënyra të thjeshta të matjes së gjatësisë - Përdorimi i terminologjisë: më i gjatë se; më i shkurtër se.</p> <p>- Klasifikimi sipas gjatësisë dhe lartësisë</p> <p>- Renditja sipas gjatësisë, dhe lartësisë.</p> <p>- Përdorimi i terminologjisë: më i rëndë se; më i lehtë se....</p> <p>- Përdorimi i kalendarit</p> <p>- Dita; java; muaji;viti dhe stinët.</p> <p>- Fjalët që tregojnë kohë: në mëngjes; në drekë etj.</p> <p>- Renditja e ngjarjeve brenda një dite</p>
<p><b>4. MODELE, MARRËDHËNI E DHE FUNKSIONE</b></p>	<p><b>4.1 Modele dhe krahasime të tyre</b></p> <p><b>4.2 Cilësitë e përbashkëta të</b></p>	<p>Fëmija duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ndjekë ritmin me një nga elementët duke</li> </ul>	<p>- Modelime sipas një rregulli të caktuar</p> <p>- Krahasimi i modelimeve të ndryshme</p> <p>- Klasifikimi i sendeve</p>

	<b>elementëve të një grupi tij</b>	<p>zbuluar rregullin në modelin e dhënë, sipas formës, ngjyrës, madhësisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të klasifikojë grupe sendesh sipas një cilësie të përbashkët.</li> </ul>	sipas një ose më shumë cilësive të përbashkëta
<b>5. MBLEDHJA E TË DHËNAVE</b>	<b>Regjistrimi dhe grumbullimi i të dhënave</b>	<p>Fëmija të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexon tabelat e grumbullimit të të dhënave (p.sh. për javën: 3 ditë me shi; 2 ditë me re; 1 ditë me diell dhe 1 ditë me erë)</li> </ul>	- Leximi i tabelave me të dhëna

### **MATERIALET**

- Materiale të imta; materiale të riciklueshme; petëza; tabela manjetike; grafikë të numrave; kuti me forma të ndryshme; birila; numëratore me gogla; vargje me gogla; fletëpalosje për të lidhur numrin me sasinë; lodra të ndryshme; kuba; lapsa; fleta me dhe pa ngjyra; kavaleta pikturë etj.
- Petëza; tabela manjetike;; kuti me forma të ndryshme; lodra të ndryshme; kuba; lapsa; fleta me dhe pa ngjyra; kavaleta pikturë, figura gjeometrike me forma dhe ngjyra të ndryshme; trupa gjeometrikë; mjete rrethore; fije shkrepse; shkopinj didaktikë; etj.
- Grupe sendesh, objektsh, letra formati, lapsa, lapustila, lapsa me ngjyra, kavaleta pikturë etj. Grupe sendesh, objektsh, letra formati, lapsa, lapustila, lapsa me ngjyra, etj



### 3. PROGRAMI I ZHVILLIMIT SHKENCOR

#### I. LINJAT KURRIKULARE

- A. INVESTIGIMI SHKENCOR, ARSYETIMI DHE LOGJIKA
- B. FORCA, LËVIZJA Dhe ENERGJIA
- C. MATERIALET
- D. PROCESET JETËSORE
- E. NDËRMARRËDHËNIA NË TOKË, HAPËSIRË DHE SISITEM
- F. NDRYSHIMET DHE CIKLI JETËSOR
- G. BURIMET

#### II. Programi I detajuar sipas linjave,objektivave dhe koncepteve

Linjat	Objektivat e nxënies	Konceptet bazë
<b>A. INVESTIGIMI SHKENCOR, ARSYETIMI DHE LOGJIKA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fëmijët do të mësohen me vëzhgim.</li> <li>• Fëmijët do të vëzhgojnë dhe të kuptojnë që qeniet njerëzore kanë shqisa.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqisat kryesore</li> <li>• Organet e shqisave</li> <li>• Ndjesitë</li> </ul>
<b>B. FORCA, LËVIZJA DHE ENERGJIA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fëmijët do të vëzhgojnë magnetet dhe dukurinë që ndodh kur ato bashkëveprojnë me materiale të tjerë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Manjetizim / jomanjetizim</li> <li>• Metal / jometal</li> </ul>
<b>C. MATERIALET</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fëmija do të vëzhgojë që objektet mund të përshkruhen në bazë të karakteristikave të tyre fizike.</li> <li>• Fëmija do të vëzhgojë dhe të kuptojë që uji ka veti që e bëjnë të dallohet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngjyrat bazë</li> <li>• Figurat (rreth, trekëndësh, katror)</li> <li>• Masa (i madh, i vogël, e hollë, e trashë, e gjatë, e shkurtër)</li> <li>• Uji merr forma të</li> </ul>

		ndryshme.
<b>D. PROCESET JETËSORE</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fëmija do të investigojë dhe të kuptojë nevojat bazë dhe proceset jetësore të njerëzve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të ngjashëm</li> <li>Identifikimi nëpërmjet emrit</li> </ul>
<b>E. NDRYSHIMET DHE CIKLI JETËSOR</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fëmija do të vëzhgojë dhe të kuptojë shembuj të thjeshtë, modele nga jeta e tij e përditshme.</li> <li>Fëmija do të vëzhgojë dhe të kuptojë që ndryshimet ndodhin vazhdimisht dhe shpejtësia e tyre është e ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Stinët</li> <li>Muajt e vitit</li> <li>Ditët e javës</li> <li>Vëzhgimi i motit (ngrohtë, ftohtë, shi, diell)</li> <li>Ndryshimet mund të njihen, shikohen dhe mund të maten (ngadalë, shpejt).</li> </ul>
<b>F. BURIMET</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fëmija do të vëzhgojë dhe të kuptojë që materialet mund të ripërdoren, riciklohen dhe të ruhen.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikim materialesh</li> <li>Përshkrimi i materialeve</li> <li>Mbeturinat e riciklueshme</li> </ul>

#### 4. MATERIALE DIDAKTIKE

- Gërshërë me majë të rrumbullakët, të vogla dhe të mesme
- Vizore me gjatësi 20 cm.
- Trekëndësh
- Kompas të thjeshtë
- Furça për lëndën ngjitëse
- Letër vizatimi e bardhë, që nuk grisët lehtë
- Letër me ngjyrë: e kuqe, e kaltër, e verdhë etj.
- Lapsa, lapsa të butë vizatimi
- Pastela (të paktën 8 ngjyra)
- Shenjues me ngjyra të ndryshme
- Bojëra, bojëra uji, tempera
- Ngjitës
- Argjilë, plastelinë
- Shkumësa me ngjyra

- Pineska
- Shirit mbulues
- Mjete për të punuar me argjil
- Gjilpëra për qepjen e copave, letrave etj.

***Materiale për mësuesin:***

- Kapëse letre
- Vizore
- Gërshërë me majë të mprehtë
- Hapëse vrimash në letër
- Makinë për lidhjen e letrës dhe kapëse
- Shirit mbulues
- Pineska
- Mjete për pastrim
- Sfungjer
- Copa të ndryshme
- Prerës letre
- Enë uji

***Materiale të mbledhura me ndihmën e prindërve.***

- Letër të vjetër
- Kanaçe
- Lloje të ndryshme letrash (karton, letër higjienike, letër gazete)
- Copa bezesh (pambuku, leshi)
- Copa druri
- Kopsa
- Penj, spango, shirit
- Fije kashte
- Boçe pishe
- Guacka
- Gjilpëra me kokë, kapëse (rrobash)
- Piktura të riprodhuara, kartolina, fotografi revistash
- Shkopinj, dru
- Këmisha pune, përparëse
- Enë uji etj.

## 4. ZHVILLIMI SOCIAL DHE PERSONAL

### I. LINJAT KURRIKULARE

1. RREGULLAT DHE QËNDRIMET
2. VETËSIGURIA DHE RESPEKTI PËR VETEN
3. KRIJIMI I MARRËDHËNIEVE
4. SJELLJA DHE VETËKONTROLLI
5. VETËKUJDESI
6. NDJENJA E KOMUNITETIT

### II. PROGRAMI I DETAJUAR I FORMIMIT SOCIAL, SIPAS LINJAVE, OBJEKTIVAVE DHE KONCEPTEVE

Zhvillimi Personal, Social, dhe Emocional		
Linjat	Objektivat e nxënies	Konceptet bazë
1. RREGULLAT DHE QËNDRIMET	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e pavarësisë duke treguar kujdes për zgjedhjen e veprimtarive</li> <li>• Shfaqja e konfidencës me të tjerët për bashkëpunim dhe drejtim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregulla</li> <li>• Qëndrim</li> <li>• Bashkëpunim</li> <li>• Drejtim</li> </ul>
2. VETËSIGURIA DHE RESPEKTI PËR VETEN	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të treguarit kujdes dhe shqetësim për veten</li> <li>• Të folurit lirshëm për shtëpinë dhe komunitetin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vetësiguri</li> <li>• Respekt</li> <li>• Shtëpi</li> <li>• Shkollë</li> </ul>
3. KRIJIMI I MARRËDHËNIEVE	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i marrëdhënie me anëtarët e grupit</li> <li>• Të përshtaturit e sjelljes në situata të ndryshme sociale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Marrëdhënie</li> <li>• Përshtatje</li> </ul>
4. SJELLJA DHE VETËKONTROLLI	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të treguarit kujdes dhe shqetësim për të tjerët</li> <li>• Të përshtaturin e të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vetëkontroll</li> <li>• Sjellje</li> <li>• Shqetësim</li> </ul>

	sjellurit sipas situatës	
5. VETËKUJDESI	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ndërmarrurit e iniciativave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Iniciativë</li> <li>• Vetëkujdes</li> </ul>
6. NDJENJA E KOMUNITETIT	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfaqja e fortë e ndjenjës së komunitetit si një anëtar i komuniteteve të ndryshme (për shembull në familje, në shkollë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komunitet</li> </ul>

### III. MATERIALE DIDAKTIKE

- Postera
- Tabela të ndryshme
- Harta të qytetit dhe të komunitetit
- Fletore vizatimi

# EDUKIMI ARTISTIK

## Linjat kurrikulare

1. drama
2. muzika
3. arti figurativ
4. vallëzimi

## Programi i detajuar sipas objektivave dhe koncepteve.

Nr	Linjat	Objektiva	Konceptet
1.	Dramë	<p>Fëmija i kësaj moshe duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të luajë në një pjesë teatrale.</li> <li>• Të motivohet për të qenë sa më skenik.</li> <li>• Të përshtatë sipas rolit <i>veshjet ose maskat, skenën e improvizuar.</i></li> <li>• Të përshkruajë me fjalë të thjeshta, një pjesë të thjeshtë teatrale si: <i>Borbardhën, Kësulkuqen.</i></li> <li>• Të luajë pjesë të thjeshta me <i>dy-tre personazhe.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesë e thjeshtë teatrale</li> <li>- Personazhe</li> <li>- Kostume</li> <li>- Maska</li> </ul>
2.	Muzikë	<p>Fëmija i kësaj moshe duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dallojë <i>tingujt nga mjedisi dhe muzika.</i></li> <li>• Të dallojë <i>tingujt nga zhurmat.</i></li> <li>• Të zhvillojë <i>ndjenjën ritmike</i> në muzikë.</li> <li>• Të imitojë me zë <i>tingujt e veglave muzikore.</i></li> <li>• Të dallojë zërat e shokëve, duke i përcaktuar ato.</li> <li>• Të zbatojë karakterin e ritmit <i>shpejt - ngadalë</i> në</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Tinguj natyralë dhe tinguj muzikorë</li> <li>- Zhurmat</li> <li>- Ritmi</li> <li>- Shpejt – ngadalë</li> <li>- Zëri (folës dhe vokal)</li> </ul>

		<p>këngë apo në lojë muzikore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të këndojë këngë të thjeshta për fëmijë me tematika të ndryshme.</li> <li>• Të luajë dhe këndojë lojëra të thjeshta muzikore.</li> <li>• Të ndërtojë vegla muzikore me objektet që kanë përreth.</li> <li>• Të dëgjojë muzikë dhe melodi, duke shoqëruar atë me lëvizje trupore.</li> <li>• Të dëgjojë muzikë të krahinave të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Kënga</b></li> <li>- <b>Dëgjimi</b></li> <li>- <b>Imitimi</b></li> </ul>
3.	<b>Arti figurativ</b>	<p>Fëmija i kësaj moshe duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përdorë <i>mjete dhe materiale</i> të ndryshme.</li> <li>• Të vizatojë <i>llojet e vijave</i>: të shkurtra, horizontale, të gjata, të valëzuara.</li> <li>• Të përcaktojë <i>ngjyrat bazë</i> në mjedisin që e rrethon: e kuqe, e verdhë, jeshile.</li> <li>• Të përcaktojë <i>figura të thjeshta gjeometrike</i>.</li> <li>• Të punojë me ndihmën e <i>shabllonit</i>.</li> <li>• Të punojë me <i>plastelinë</i> dhe <i>argjil</i>.</li> <li>• Të vlerësojë punët e vet dhe të tjerëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mjete dhe materiale</b></li> <li>• <b>Vijat</b></li> <li>• <b>Ngjyrat bazë</b></li> <li>• <b>Format</b></li> <li>• <b>Modelet, shabllone</b></li> </ul>

4.	<b>Vallëzimi</b>	<p>Fëmija i kësaj moshe duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të koordinojë <i>melodinë</i> me <i>lëvizjet e trupit</i>.</li> <li>• Të vallëzojë duke zbatuar dinamikën: <i>shpejtë - ngadalë</i>.</li> <li>• Të kërcejë duke mbajtur ritmin (nëpërmjet goditjeve me shuplakave).</li> <li>• Të imitojë lëvizje të thjeshta të kërcimit: popullore etj.,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Trupi</b></li> <li>• <b>Hapësira</b></li> <li>• <b>Lëvizjet</b></li> <li>• <b>Dinamika (shpejt, ngadalë)</b></li> <li>• <b>Figura vallëzuese</b></li> </ul>
----	------------------	--	---

## EDUKIMI FIZIK DHE SHËNDETËSOR

### Linjat kurrikulare

1. Lëvizja
2. Orientimi në hapësirë
3. Shëndeti dhe trupi
4. Përdorimi i pajisjeve
5. Përdorimi i mjeteve dhe i materialeve

I. Programi i detajuar sipas objektivave dhe koncepteve.



<b>Nr</b>	<b>Linjat</b>	<b>Objektivat</b>	<b>Koncepte</b>
1	<b>Lëvizja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lëvizë lirshëm me kënaqësi dhe vetëbesim gjatë lojërave në mjedisin ku jeton</li> <li>• Të kryejë lloje të ndryshme veprimesh si: <i>vrapim, kërcim, rrëshqitje, zgjatje, rrotullim</i> etj.</li> <li>• Të orientohet në hapësirë kur luan.</li> </ul>	<b>Ecje, Lëvizje (vrapim, kërcim, rrotullim, rrëshqitje, zgjatje, përkulje) Kohë</b>
2	<b>Orientimi në hapësirë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ulet, të ngrihet dhe balançohet me pjesët e ndryshme të trupit.</li> <li>• Të vetëkontrollohet në një pozicion fiks.</li> </ul>	<b>Hapësirë Natyrë Përshtatje Lojë Drejtim Afër-Larg, Lart-poshtë</b>
3	<b>Shëndeti dhe trupi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të zbulojë vetveten.</li> <li>• Të bashkëpunojë me shokët në ndarjen e detyrave.</li> <li>• Të kryejë praktikat higjieno-sanitare gjatë ngrënies dhe fjetjes.</li> </ul>	<b>Kolonë Skuadër I gjatë-i shkurtër I hollë – i trashë</b>
4	<b>Përdorimi i pajisjeve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të rrisë kontrollin gjatë përdorimit të pajisjeve dhe konstruksioneve.</li> </ul>	<b>Objekt Ndërtim Lartësi</b>
5	<b>Përdorimi i mjeteve dhe i materialeve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të krijojë modele me dy tri pjesë.</li> <li>• Të presë dhe të ngjisë modele të thjeshta.</li> <li>• Të mirëmbajë mjetet dhe materialet që ka në përdorim.</li> </ul>	<b>Prerje Mirëmbajtje</b>

#### **Mjete të domosdoshme:**

- Paralele druri në mjedisin e kopshtit,
- topa, litarë,
- stola gjimnastikor,
- flamur,
- dyshek gjimnastikor,
- ballona, trarë të vegjël ekuilibri,
- birila, rathë, shkopinj gjimnastikorë,

- kapele kartoni, spango, materiale ndërtimi, etj.